



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 759 Prot.

Tiranë, më 16._05.2024

V E N D I M

Nr. 136, datë 16 .05. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 171 Regj, datë 19.09.2023, paraqitur nga ankuesi z. D.U kundër kundër Institutit të Statistikave (INSTAT), me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “*prejardhjes*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi D.U, shpjegon se, më datë 06.07.2023, me anë të një broshure, është njoftuar që INSTAT kërkon njerëz për Censin 2023. Pasi ka lexuar broshurën, e ka konsideruar veten të përshtatshëm për këtë punë me afat të përcaktuar. Megjithatë, aplikimin e ka bërë më datë 10.08.2023. z. U shpjegon se, aplikoi për “anketues terreni”, si pozicion më i përshtatshëm për moshat e reja, që janë më praktikë në terren dhe më të njohur me teknologjinë, e cila është pjesë shumë e rëndësishme e këtij Censi.

Ankuesi informon se, me datë 25.08.2023, në orën 10:00, ka marrë një thirrje nga numri i telefonit +0355 6850 98261. Dy minuta më vonë, ka zhvilluar një bisedë 46 sekonda me një person, i cili nuk i është prezantuar me emër, por vetëm si “koordinator i INSTAT për Censin 2023 në Bashkinë Vau-Dejës”. Ky person e ka pyetur në lidhje me zonat që ishte i gatshëm të punonte dhe ankuesi i është përgjigjur që mund të mbulonte lagjen Dejë, si dhe fshatrat përreth, por në rast se i kërkohej, i ka thënë se mund të punonte në çdo zonë të Njësisë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Me pas, ky person i ka thënë që nuk ishte plotësuar numri i anketuesve dhe sapo ky numër të plotësohej, do ta kontaktonte për hapat e mëtejshëm (trajnimet etj) Që prej asaj dite, deri më datë 13.09.2023, ankuesi informon se nuk ka marrë asnjë njoftim apo përgjigje, në asnjë formë (letër, e-mail apo telefon)

Më datë 13.09.2023, ankuesi deklaroi se, me anë të lajmeve në televizion, ka mësuar që më 18 shtator fillonte Censin 2023. Pas këtij lajmi, në të njëjtën ditë, në orën 14:57, ka telefonuar +355 xxxxxxxx, numër që i përkiste personit të prezantuar si “koordinatori i INSTAT për Censin 2023 në Bashkinë Vau-Dejës” dhe e ka pyetur në lidhje me trajnimin, i cili në fakt kishte nisur që më datë 04 shtator. Ky person i është përgjigjur që ankuesi nuk ishte përzgjedhur dhe se nga 17 aplikime ishin përzgjedhur 10. Ankuesi nuk mori asnjë shpjegim tjetër.

Mënyrat e papërshtatshme (informale) të kontaktit, si dhe fakti që njëherë i ishte komunikuar që nuk kishte patur aplikime dhe më pas iu komunikua që kishte patur 17 aplikime për 10 pozicione, e ka bërë ankuesin të dyshojë që diçka nuk shkonte.

Ankuesi shprehet se ka telefonuar INSTAT në numrin zyrtar. Receptsi e ka lidhur me një punonjëse të INSTAT, me të cilën gjatë bisedës e ka pyetur se në çfarë kriteresh ishin bazuar për të bërë përzgjedhjen dhe përse nuk ishte njoftuar zyrtarisht, por punonjësja nuk ishte në gjendje të përgjigjej, ndërsa punonjësja përgjegjëse për Qarkun Shkodër nuk gjendej në zyrë.

Më datë 16.09.2023, në orën 09:58, ankuesi informon se ka marrë një telefonatë nga numri +355 xxxxxxxx. Telefonuesja, H.D, i është prezantuar si punonjëse e INSTAT, duke i ofruar punën e anketuesit në terren në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau-Dejës. Ankuesi i është përgjigjur se do ta konsideronte si punë. Po këtë ditë, në orën 11:14, ka marrë një telefonatë në aplikacionin WhatsApp nga numri +355 xxxxxxxx. Telefonuesja është prezantuar si E.D, përfaqësues i INSTAT në Bashkinë Vau-Dejës, duke i ofruar të njëjtën punë si parafolësja dhe u shpreh që për Njësinë Administrative Vau-Dejës kishte patur shumë aplikime, ndryshe nga ajo që i ishte thënë nga një tjetër punonjës në datën 25.08.2023. Për më tepër, përfaqësuesi i INSTAT i komunikoi ankuesit se, shpenzimet e rrugës dhe të tjera, nuk përfshiheshin në pagesat e INSTAT, pra duhet t'i mbulonte vetë ankuesi.

Ankuesi shpjegon se, Njësia Administrative Temal, ndodhet rreth 50 km larg Njësisë Administrative Vau-Dejës. Temali është një zonë malore, me karakteristika kulturore të ngjashme me Malësinë e Gjakovës, zonë nga e cila ankuesi ka prejardhjen. Duke u bazuar në faktet, të cilat më së shumti janë bisedat me punonjësit e INSTAT, ai dyshon që prejardhja e tij është shkak i diskriminimit që kanë kryer punonjësit e INSTAT në Bashkinë Vau-Dejës ndaj tij, njëherë duke mos e përzgjedhur për pozicionin e anketuesit në terren për Censin, pastaj duke i ofruar një pozicion në një zonë shumë larg tij, ku duhet të mbulonte vetë shpenzimet personale, dhe se ai ishte më i përshtatshëm për atje (Temal) sepse ishin “malësorë”.

Ankuesi thekson se, diskriminimi është bërë për shkak të prejardhjes, sepse Njësia Administrative Vau-Dejës, është një zonë e populluar kryesisht nga zadrimerët dhe mirditorët, me të cilët ai thekson

se nuk ka patur ndonjëherë ndonjë problem me bazë “racizmin” apo tjetër lloj. Sipas ankuesit, përzgjedhja e punonjësve për Censin 2023 është bërë me bazë prejardhjen, ku punonjësit lokalë të INSTAT, kanë përzgjedhur njerëz të afërm, apo me prejardhje nga e njëjta zonë me ta. Ankuesi shprehet se, Bashkia Vau-Dejës është një bashki thellësisht e politizuar, ku vendet e punës paracaktohen nga lidhjet politike, por duke qenë se ankuesi nuk është person që ka angazhim politik të asnjë lloji, nuk mund të thotë që punonjësit e INSTAT në Bashki e kanë përjashtuar për arsye politike. Fakti që punonjësit e INSTAT fokusohen tek mbiemri, si dhe pyesin vazhdimisht “i kujt je?”, do të thotë që nuk janë profesionalë dhe janë të prirur për të avantazhuar apo disavantazhuar sipas krahinës nga personi ka prejardhjen, apo nga njoftësi të ndryshme.

Ankuesi shprehet se, fakti që i kanë ofruar punë si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, vërteton pretendimin e tij që ai ishte i përshtatshëm për këtë pozicion pune, ndërsa thënie kontradiktore të punonjësve të INSTAT, ku njëri thotë që nuk ka patur aplikime dhe është shtyrë afati për to, ndërsa tjetri thotë që ka patur shumë aplikime, aq sa nuk ka patur asnjë mundësi që ai të punonte si anketues terreni në Njësinë Administrative ku banon, vërteton pretendimin e tij se është diskriminuar për shkak të prejardhjes. Gjithashtu, ankuesi thekson se, komunikimet informale nuk janë të denja për INSTAT. Sipas tij, INSTAT duhet të kishte qenë më i qartë dhe formal në lidhje me aplikimet, zgjatjen e afateve (nëse ka patur), kriteret mbi të cilat janë përzgjedhur punonjësit, komisioni apo individi që ka bërë vlerësimet etj.

z. U, deklaron se është i papunë dhe aktualisht është student. Për shkak të këtij diskriminimi me baza krahinore, prejardhjes së tij, ai ka humbur mundësinë që të punojë dhe të paguhet në një shumë e cila për të është domethënëse, pasi do të kishte mbuluar shpenzimet e studimeve me të ardhurat që mund të fitonte. Sipas tij, ky diskriminim, përveç dëmit psikologjik që sjell çdo lloj diskriminimi, ka sjellë edhe një dëm financiar, i cili për të nuk është i papërfillshëm.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri kryerjen e një hetimi të thelluar të çështjes për të vërtetuar apo gjetur arsyen e vërtetë të diskriminimit, personin apo grupin e personave përgjegjës dhe marrjen e masave sipas përcaktimeve ligjore, duke përfshirë edhe dëmshpërblimin.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS,*

shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/b, të LMD përcaktohet: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;*”

1. Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës u konstatua se ankesa nuk ishte e plotë, veçanërisht në lidhje me dokumentacionin provues që lidhej me shkakun e pretenduar të diskriminimit “prejardhjes”. Nëpërmjet e-mailit të datës 26.09.2023, ankuesit iu kërkua plotësimi i ankesës. Nëpërmjet e-mailit të datës 05.10.2023, ankuesi plotësoi ankesë me informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar me procedurën e shqyrtimit të ankesës. Ndër të tjera, ankuesi parashitroi:

Malësia e Gjakovës është një krahinë që shtrihet nga Rrethi i Tropojës deri në Kosovë, konkretisht Gjakovë dhe zonat përreth. Vendlindja e babait tim është Gjonpepaj, Njësi Administrative në Bashkinë Tropojë. Mbiemri “U.” është mbiemër karakteristik i zonës së Nikaj-Merturit, pjesë e Malësisë së Gjakovës. Sipas ankuesit, shkeljet e vazhdueshme të kryera nga përfaqësues të INSTAT në Bashkinë Vau-Dejës, ngrejnë dyshime të arsyeshme që janë kryer për shkak të prejardhjes së tij. Ankuesi thekson se, nuk gjen arsye tjetër për mospunësimin tim si “anketues terreni”, përveç diskriminimit për shkak të prejardhjes. Sipas ankuesit, fakti që janë punësuar njerëz që kanë lidhje familjare dhe shoqërore me punonjës dhe ish punonjës në këtë bashki, mbështet më shumë pretendimin tim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

2. Me shkresën me nr.1013/1 prot., datë 16.10.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga INSTAT, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
3. Me shkresën nr.2011/1 prot., datë 26.10.2023, INSTAT, ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën duke parashtruar ndër të tjera:

INSTAT në kuadër të kryerjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, ka publikuar shpalljen për kontraktimin e Anketuesve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përzgjedhja e individëve kandidatë ofruet të shërbimit për mbledhjen e të dhënave është bërë në përmbushje të kërkesave që lindin nga ligji nr.140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Për arsye të kompleksitetit dhe numrit të madh të personelit përgjegjës për Censin në terren, INSTAT-i është investuar në zhvillimin e një platforme aplikimi online (aplikacioni HRM) për të gjitha aplikimet në nivel kombëtar në faqen www.rekrutimecensi.instat.gov.al. Për arsye të numrit të madh të kandidatëve dhe individëve për t’u kontraktuar në kuadër të këtij aktiviteti (më shumë se 6000 punonjës), është ndjekur procedura e aplikimit online dhe përzgjedhja është bërë duke marrë në konsideratë të dhënat e aplikantëve. Nëpërmjet algoritmeve të tij, sistemi ka ndihmuar në kontrollin e plotshmërisë së dokumentacionit të kërkuar dhe hartimin e listës së kandidatëve të përzgjedhur.

Lidhur me rastin konkret, nga gjenerimi i të dhënave të programit, rezulton se, z.D.U ka aplikuar në portalin online për t’u kontraktuar si anketues në Bashkinë Vau i Dejës, Prefektura Shkodër, në datën 8/10/2023 ora 12:16:06. Referuar kërkesave dhe natyrës së këtij pozicioni pune nga databaza e aplikantëve janë përzgjedhur disa nga kandidatët të cilët janë kontaktuar nga punonjësit e INSTAT-it të zyrave rajonale në nivel qarku, për të vazhduar procesin e kontraktimit. Në kandidatët e përzgjedhur ka qenë edhe z.D.U, i cili është kontaktuar nga punonjësit e INSTAT-it dhe është njoftuar për përcaktimin si anketues në Njësinë Administrative Temal. Pasi ka kërkuar kohë për t’u menduar, në fund ka njoftuar për mospranimin e shërbimit në këtë zonë. Për këtë arsye, marrëdhënia ndërmjet INSTAT-it dhe z.U nuk është finalizuar me kontratë, gjë që nuk ka krijuar detyrime financiare apo të tjera ndërmjet palëve.

Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë dhe përmasat e këtij procesi dhe numrin e madh të njerëzve të angazhuar, ndaj ankuesit në gjykimin tonë nuk ka ndodhur asnjë formë e diskriminimit, por ndaj tij janë ndjekur të njëjtat procedura rutinë, si me të gjithë aplikantët e tjerë.

4. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 01.11.2023, ankuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij, duke parashtruar ndër të tjera se:

INSTAT është shprehur që përzgjedhja është bërë nga sistemimi në bazë të algoritmeve të tij. Në vijim, INSTAT shpjegon që fakti i aplikimit ka qenë 31.07.2023, por nuk shpjegon pse ky afat është shtyrë të paktën një herë deri me datë 10.08.2023, kur edhe kam bërë aplikimin. Në lidhje me procedurën e rekrutimit, INSTAT nuk tregon periudhën e përzgjedhjes, as trajnimin të punonjësve

të INSTAT për Censin 2023. Gjithashtu, nuk tregohet për mënyrën e njoftimit të punësimit, ose të refuzimit nga ana e punonjësve të INSTAT.

INSTAT nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me arsyet se përse ankuesi nuk është përzgjedhur si anketues terreni në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës.

Në vijim të përgjigjes, INSTAT pretendon se ai është përzgjedhur dhe kontraktuar nga punonjësit e zyrave rajonale. Ankuesi thekson se, më datë 13.09.2023, ka telefonuar personin e prezantuar si “kordinator i INSTAT për Censin 2023 në Bashkinë Vau-Dejës”, i cili i ka komunikuar se nuk ishte përzgjedhur. Pozicioni i punës si “anketues terreni” në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, i është ofruar më datë 16.09.2023, ndërkohë që periudha e kontraktimit, sipas informacionit të vënë në dispozicion nga INSTAT, ka qenë 04.09.2023-03.11.2023. Ankuesi parashtron se, kur ka marrë dijeni nëpërmjet televizionit për fillimin e Censit, kanë qenë ditët e fundit të trajnimit të punonjësve, gjë që bie ndesh me ligjin për punësimin në INSTAT për Censin 2023 (i cili parashikon trajnimin para fillimit të anketimit), si dhe me pretendimin e INSTAT se është përzgjedhur në një proces të rregullt si gjithë aplikantët e tjerë.

Sipas informacionit të dhënë nga INSTAT mbi kriteret e përzgjedhjes së anketuesve, del qartë një tjetër shkelje e punonjësve të INSTAT në Bashkinë Vau i Dejës. Te kriteret e përzgjedhjes, ndër të tjera thuhet “ të jetë banues i njësisë administrative ku do të angazhohet në Cens”. Pra, oferta për punë si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi ankuesi banon në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau-Dejës, gjë e cila ka qenë e sqaruar edhe në aplikim, përveç bisedave informale (nëpërmjet telefonit) me punonjësit e INSTAT.

5. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 19.12.2023. Zhvillimi i seancës dëgjimore i’u njoftua palëve me shkresën nr. 1013/2 prot., datë 07.12.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 19.12.2023 me pjesëmarrjen e palës ankuese, përfaqësuar gjatë seancës nga z. E.Sh, përfaqësues me prokurë të posaçme nr. 4375 rep dhe nr.854 kol datë 18.12.2023, hartuar para noteres E. E. H, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkodër. Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të INSTAT, i cili rezulton se ka marrë rregullisht dijeni për datën dhe orën e seancës dëgjimore, fakt ky që rezulton i provuar sipas lajmërim marrjes postare.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi me prokurë i palës ankuese deklaroi se, me shkakun e pretenduar të diskriminimit “prejardhje” i referohen origjinës së ankuesit. Ankuesi e ka origjinën nga Malësia e Gjakovës. Bashkia Vau i Dejës është një bashki që banohet nga Mirditorë dhe Zadrivorë dhe kjo mendohet se ka ndikuar në përzgjedhjen e aplikantit.

I pyetur gjatë seancës dëgjimore se përse pala ankuese pretendonte se trajtimi i pafavorshëm ka ardhur si pasojë e origjinës nga Malësia e Gjakohës, përfaqësuesi me prokurë i palës ankuese u përgjigj se ky pretendim bazohej kryesisht duke njohur mentalitetin e zonës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi D.U, është i datëlindjes 08.10.2001, vendlindja Shkodër. Bazuar në të dhënat e pasqyruara në certifikatën familjare me nr.serial 000942201, lëshuar në datën 02.09.2020, ankuesi figuron i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës. Referuar të dhënave të pasqyruara në certifikatën familjare, rezulton se babai i ankuesit ka si vendlindje Gjonpepaj, Tropojë ndërsa nëna ka si vendlindje Toplanë, Shkodër.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se në datën 10.08.2023, ankuesi ka aplikuar nëpërmjet platformës *online* të zhvilluar nga INSTAT për rekrutimin e personelit në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 (në vijim censi 2023), në nivel kombëtar në faqen www.rekrutimecensi.instat.gov.al, për pozicionin e punës “anketues terreni”.

Në vijim të aplikimit për pozicionin e mësipërm, ankuesi është njoftuar nga INSTAT se është përzgjedhur si anketues në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës. Ankuesi nuk e ka pranuar propozimin për t’u punësuar në pozicionin “anketues terreni” në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës.

Pretendimet e ankuesit në lidhje me komunikimet që ka patur me punonjës të INSTAT gjatë procesit të rekrutimit për pozicionin e punës në të cilin kishte aplikuar dhe përmbajtja e pretenduar nga ankuesi e komunikimeve, nuk rezultuan të provuara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës.

Ankuesi pretendon se, është diskriminuar për shkak të të prejardhjes së familjes së tij nga Malësia e Gjakovës, ndërsa Njësia Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës është një zonë e populluar kryesisht nga zadrimerë dhe mirditorë. Sipas ankuesit, përzgjedhja e punonjësve për Censin 2023 është bërë me bazë prejardhjen, ku punonjësit lokalë të INSTAT, kanë përzgjedhur njerëz të afërm apo me prejardhje nga e njëjta zonë me ta. Fakti që punonjësit e INSTAT fokusohen tek mbiemri, si dhe pyesin vazhdimisht “i kujt je?”, do të thotë që janë të prirur për të avantazhuar apo disavantazhuar sipas krahinës nga personi ka prejardhjen. Ankuesi shpreh se, fakti që i kanë ofruar punë si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, vërteton pretenimin e tij që ai ishte i përshtatshëm për këtë pozicion pune, ndërsa thëniet kontradiktore të punonjësve të INSTAT, vërteton pretendimin e tij se është diskriminuar për shkak të prejardhjes.

Sa më sipër ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr.171, datë 19.09.2023 kundër INSTAT, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të prejardhjes, gjatë procesit të aplikimit për pozicionin e punës “anketues terreni”, në kuadër të rekrutimeve për punonjësit e Censit 2023.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes është objekt shqyrtimi, konstatohet se kemi të bëjmë me mundësinë për të patur akses në një marrëdhënie punësimi të përkohshme, në kuadër të zhvillimit të procesit të Censit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri për vitin 2023.

Në këtë kuadër fillimisht, Komisioneri do të marrë në shqyrtim dhe do të analizojë kuadrin e posaçëm ligjor dhe nënligjor në lidhje me procesin e zhvillimit të Censit dhe në mënyrë të veçantë ato rregullime që kanë të bëjnë me mënyrën dhe procedurën e punësimit të personelit të Censit.

Censi i Popullsisë dhe Banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, rregullohet nga ligji nr.140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe Banesave”. Sipas këtij ligji, censi është mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të marra, në mënyrë që të sigurohet numërimi i plotë i të gjithë individëve, njësisive ekonomike familjare, banesave dhe ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në një moment të vetëm në kohë, si dhe prodhimi i statistikave në lidhje me karakteristikat demografike, ekonomike e sociale të popullsisë së Shqipërisë. (neni 3, germa “e”, të ligjit nr.140/2020).

Referuar nenit 6, të ligjit nr.140/2020, INSTAT është institucioni i cili organizon dhe zbaton censin, me mbështetjen e Komisionit Qendror të Censit dhe komisioneve të censit në nivel bashkie.

Bazuar në pikën 1, germa “e” të nenit 14 “Përgjegjësitë e Institutit të Statistikave”, të ligjit nr.140/2020, përcaktohet se: “ 1. Instituti i Statistikave (INSTAT) ka këto përgjegjësi:..... e) kryen procedurat e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe trajnimit të stafit të terrenit me mbështetjen, sipas nevojës, të komisioneve të censit në nivel bashkie;”

Neni 19, i cili parashikon personelin e cendit, përcakton: “1. Personeli i censit përbëhet nga: a) stafi i terrenit, i cili pajiset nga INSTAT-i me një shenjë dalluese të zyrtarizuar dhe ka në përbërje: i. anketuesit, të cilët shkojnë në çdo banesë brenda territorit të caktuar të mbledhjes së të dhënave për të intervistuar banorët dhe për të plotësuar tërësisht dhe me saktësi pyetësin e censit;.....2. INSTAT-i përcakton kriteret dhe ngre një komision ad-hoc vlerësimi për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit të censit.”

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara, rezulton se, në kuadër të kryerjes së Censit të Popullsisë dhe banesave 2023, INSTAT ka publikuar shpalljen për kontraktimin e anketuesve në të gjithë territorin e Shqipërisë. Nuk u administruan të dhëna në lidhje me datën e shpalljes.

Në shkresën nr.2011/1 prot, datë 26.10.2023, INSTAT shprehet se, përzgjedhja e individëve kandidatë ofruet të shërbimit për mbledhjen e të dhënave është bazuar në kërkesat që lindin nga

ligji nr.140/2020. Nga shqyrtimi i këtij ligji, Komisioneri konstaton se, ai nuk ka përcaktuar kritere në lidhje me përzgjedhjen e kategorive të ndryshme të personelit të censit, përfshi këtu edhe pozicionin “anketues terreni”, për të cilin ka aplikuar ankuesi. Referuar pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr.140/2020, përcaktohet se është INSTAT, i cili përcakton kriteret për përzgjedhjen e personelit të censit, përfshi pozicionin “anketues terreni”.

Referuar shpalljes së publikuar për pozicionin “anketues terreni” në të gjithë territorin e vendit, rezulton se INSTAT ka përcaktuar se kriteret e përzgjedhjes më këtë pozicion pune janë: - të jetë shtetas shqiptar; - të jetë të paktën 18 vjeç; - të ketë aftësi të mira në përdorimin e pajisjeve elektronike, në mënyrë të veçantë tabletëve; - të jetë i aftë të lëvizë në distanca të largëta; - të jetë banues i njësisë administrative ku do të angazhohet në Cens; - të zotërojë aftësi të mira komunikuese; - personat me eksperiencë të mëparshme në vrojtime përbëjnë avantazh.

Në faqen e dedikuar për punësimin e personelit të Censit 2023, rezulton se INSTAT ka publikuar edhe materialet dhe informacionet informuese për të lehtësuar procesin e aplikimit, në formë të shkruar dhe me video³. Nga shqyrtimi i këtyre materialeve informuese, rezulton se të dhënat e detyrueshme që një aplikant ka deklaruar në platformën e aplikimit për të punuar në cens 2023 janë:

Të dhënat personale, ku përfshihen, emri, mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, adresa elektronike, dhe fotoja e aplikantit. Të dhënat në lidhje me vendbanimin që duhet të përcaktojë në sistem aplikanti janë, prefektura, bashkia, njësia administrative, adresa dhe numri i telefonit, fshati është opsional. Në vijim aplikanti plotëson edhe të dhënat në lidhje me edukimin dhe eksperiencat. Vetëm pasi ka plotësuar këto të dhëna, aplikanti mund të aplikojë për shpalljet e vendeve të punës. Për të vijuar me aplikimin, aplikanti duhet të përzgjedh vendodhjen e preferuar të punësimit, duke përcaktuar Prefekturën, Bashkinë dhe Njësinë Administrative.

Në shpalljen e bërë nga INSTAT përcaktohet gjithashtu se, afati i aplikimit është data 31.07.2023, periudha e kontraktimit është nga data 04.09.2023 – 03.11.2023, ndërsa pagesa për pozicionin e punës “anketues terreni” do të kryhet bazuar në VKM nr.242, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Klasa IV, lidhja I.

Nuk rezulton që INSTAT të ketë ngritur një komision *ad-hoc* vlerësimi për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit të censit, sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 3, të ligjit nr.140/2020. INSTAT parashtrori se, për arsye të kompleksitetit dhe numrit të madh të personelit për censin në terren, është ndjekur procedura e aplikimit online për të gjitha aplikimet në nivel kombëtar në faqen dhe përzgjedhja është bërë duke marrë në konsideratë të dhënat e aplikantëve. Nëpërmjet

³ <https://www.instat.gov.al/al/cens-2023/pun%C3%ABsimi/>

algoritmeve të tij, sistemi ka ndihmuar në kontrollin e plotshmërisë së dokumentacionit të kërkuar dhe hartimin e listës së kandidatëve të përzgjedhur.

INSTAT deklaroi gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës së bazuar në databazën e aplikantëve të gjeneruar nga programi online i aplikimit, ndër aplikantët e përzgjedhur që është kontaktuar nga punonjësit e INSTAT-it të zyrave rajonale në nivel qarku për të vazhduar kontraktimin, ka qenë edhe ankuesi, i cili është njoftuar se është përzgjedhur si anketues në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga INSTAT, rezulton se, në nivel bashkie, në Bashkinë Vau i Dejës, numri i pozicioneve për anketues terreni të shpallura ka qenë 42 ndërsa numri i aplikimeve 63. Situata faktike e pozicioneve anketues terreni, sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga INSTAT paraqitet si më poshtë:

Prefektura	Bashkia	Njësia Administrative	Nr.i pozicioneve	Nr.i aplikimeve
Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Vau i Dejës	10	24
Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Bushat	22	24
Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Vig-Mnel	2	3
Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Hajmel	6	9
Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Temal	1	2
Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	Shllak	1	1
Total			42	63

Referuar shpalljes së publikuar nga INSTAT për të aplikuar për pozicionet anketues terreni në të gjithë vendin, afati i aplikimit ka qenë data 31.07.2023, ndërsa ankuesi ka aplikuar në datën 10.08.2023. Nuk u administrua gjatë shqyrtimit ndonjë informacion në lidhje me shtyrjen e afatit të aplikimit në lidhje me shpalljen e bërë për pozicionin anketues terreni. Megjithatë zgjatja faktike e afatit të aplikimit i ka mundësuar ankuesit që të aplikojë për pozicionin e punës, pasi ankuesi ka aplikuar pasi ka përfunduar afati i shpallur i aplikimit, në datë 31.7.2024.

Bazuar në kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve për pozicionin anketues terreni, të shpallura nga ana e INSTAT, konstatohet se, një nga këto kritere është *“Të jetë banues i njësisë administrative ku do të angazhohet në Cens”*.

INSTAT deklaroi se ankuesi është përzgjedhur dhe i është propozuar për të punuar si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, Prefektura Shkodër. Nga të dhënat e administruara ankuesi figuron i regjistruar në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i

Dejës. Sa më sipër, konstatohet se INSTAT i ka propozuar ankuesit një pozicion pune si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, pavarësisht se ai nuk ishte banues i kësaj njësie administrative.

Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga INSTAT, rezulton se, për 10 pozicionet e kërkuara të punës anketues terreni në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës, kanë aplikuar 24 persona. Në këtë mënyrë, vetëm 10 persona janë përzgjedhur për të punuar si anketues terreni në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës, ndërsa 14 persona, një prej të cilëve ankuesi, nuk janë përzgjedhur si anketues terreni në këtë njësi administrative. Në rastin e ankuesit, INSTAT i ka propozuar ankuesit që të punojë si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, pavarësisht se ai nuk ishte banor në këtë njësi administrative dhe pavarësisht se në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, ka qenë i shpallur vetëm një pozicion si anketues terreni, ndërsa kanë aplikuar dy persona.

Referuar dispozitave ligjore që rregullojnë punësimin e personelit të censit, të cilat janë cituar më sipër, INSTAT është institucioni i cili është përgjegjës për punësimin e personave që do të punojnë në kuadër të këtij procesi. Ankuesi gjithashtu e ka paraqitur ankesën e tij kundër INSTAT dhe kjo në mënyrë të bazuar, pasi është ky i fundit që është institucioni përgjegjës për përzgjedhjen dhe punësimin e punonjësve të censit.

Por ndërsa ankesa është paraqitur kundër INSTAT, pretendimet për diskriminim për shkak të prejardhjes së tij nga Malësia e Gjakovës, ankuesi i lidh me Bashkinë Vau i Dejës dhe personat e punësuar ose ish të punësuar në këtë bashki. Ndërsa shpjegon se Bashkia Vau i Dejës është kryesisht e banuar nga zadrivorë dhe mirditorë, ankuesi e barazon këtë me faktin që të punësuarit ose ish të punësuarit në bashki kanë gjithashtu këtë prejardhje e cila është e ndryshme nga prejardhja e tij. Në këtë mënyrë sipas ankuesit, janë përzgjedhur persona të cilët kanë lidhje familjare ose shoqërore me punonjës ose ish punonjës në Bashkinë Vau i Dejës, me prejardhje nga zadrimea ose mirdita. Komisioneri i gjen të pabazuara këto pretendime të ankuesit. Komisioneri vlerëson se këto pretendime të ankuesit janë të pabazuara edhe për faktin se, është INSTAT i cili është përgjegjës për punësimin e punonjësve të censit dhe jo bashkia dhe punonjësi rajonal i INSTAT nuk është pjesë e bashkisë por pjesë e stukturës së INSTAT.

Komisioneri vlerëson se, fakti që ankuesi është banues në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës, nuk i garanton përzgjedhjen dhe punësimin si anketues terreni, në këtë njësi administrative. Nisur nga fakti që për 10 pozicione pune si anketues terreni në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës, kanë aplikuar 24 persona, tregon se së bashku me ankuesin nuk janë përzgjedhur për këtë pozicion edhe 13 persona të tjerë.

Nuk rezulton që ndonjë nga parregullsitë ose paqartësinë gjatë procesit të punësimit të personelit të censit, e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të ndryshëm dhe më pak të favorshëm në raport me të tjerët. Kështu, zgjatja e afatit të aplikimit përtej datës 31.7.2023 e ka mundësuar ankuesin që

të përfshihet në procesin e rekrutimit të punonjësve të censit. Gjithashtu, edhe pse se nuk është përzgjedhur si anketues në Njësinë Administrative Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës, ku ka vendbanimin, ankuesit i është propozuar një pozicion tjetër i ngjashëm në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës. Pavarësisht se ankuesit i është propozuar pozicioni si anketues terreni në Njësinë Administrative Temal, Bashkia Vau i Dejës, në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes së përcaktuara nga INSTAT, pasi ankuesi nuk është banues i kësaj njësie administrative, kjo nuk e ekspozon ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Për sa më lart, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ankuesi D.U, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Institutit të Statistikave. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit D.U nga ana e Institutit të Statistikave, për shkakun e pretenduar prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër/Prejardhja
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim